



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Prishtinë, 29.12.2016

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore përmbylli një vit të sukseseshëm

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) e konsideron 2016 si vitin më të sukseseshëm që nga themelimi i institucionit.

Në bazë të kompetencave ligjore që ka KKTK për vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, sipas propozimit të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS), në vitin 2016, ka bërë shpalljen në mbrojtje të përhershme të 23 aseteve të trashëgimisë kulturore nga kategoria arkeologjike dhe arkitekturale. Duke pas parasysh se procesi i shpalljes në mbrojtje të përhershme është zhvilluar për herë të parë në Republikën e Kosovës, ky mund të konsiderohet proces historik për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Në këtë mënyrë, përbushet jo vetëm një detyrim ligjor shtetëror, por Republika e Kosovës afrohet edhe më shumë drejt anëtarësimit në UNESCO dhe institucione e mekanizma të tjerë ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Përkundër, suksesit që ka arritur KKTK me shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, gjendja në përgjithësi nuk është përmirësuar. Dëmtimi, cenimi dhe shkatërrimet e trashëgimisë kulturore kanë vazhduar në Republikën e Kosovës. Për këtë, KKTK ka reaguar në vazhdimësi duke kërkuar nga institucionet kompetente për të parandaluar përsëritjen e rasteve të tilla dhe identifikimin e përgjegjësve.

Me qëllim parandalimin e degradimit dhe humbjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, KKTK në vitin 2017, do të iniciojë procedurat ligjore para organeve përkatëse për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët i rrezikojnë, dëmtojnë apo shkatërrojnë asetet e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, nga 1 janari 2017, KKTK ka mundësuar hapjen e linjës telefonike falas për qytetarë për të raportuar parregullësitë në fushën e trashëgimisë kulturore, si shkatërrime, dëmtime dhe trafikim etj. Numri i telefonit papagesë për qytetarë është: **080011110**.

Në funksion të zhvillimit dhe avancimit institucional, KKTK ka zhvilluar takime të shumta me institucionet e trashëgimisë kulturore lokale, qendrore dhe ndërkombëtare.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) ka bërë vlerësimin e çmimit të tregut me rastin e shpronësimit të një aseti të trashëgimisë kulturore “Kulla e Sylejman Vokshit”, me kërkesë të Komunës së Gjakovës, bazuar në kompetencat ligjore.

KKTK përgjatë viti 2016, ka përbushur të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm që kanë dalë nga Raporti i vitit 2015.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka qenë i akomoduar në ndërtesë private, ndërsa nga 1 tetori 2016, KKTK është akomoduar në ndërtesë shtetërore, duke kursyer mjete për të mbuluar shpenzimet e tjera që dalin nga programi dhe plani i punës.

KKTK ka kaluar edhe nëpër disa sfida si mungesa e bashkëpunimit institucional, mospërgjigja e institucioneve në kërkesat tona, mungesa e stafit dhe mungesa e buxhetit, për të cilat besojmë dhe shpresojmë se do ti tejkalojmë gjatë vitit të ardhshëm.

KKTK zotohet që do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare në të mirë të trashëgimisë kulturore.

Me respekt,

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore